



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura III**

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr.21 -2009

Prishtinë, më 15 qershor 2009, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

**PROCESVERBAL**

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

**Morën pjesë:** Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Adem Salihaj, Ramadan Gashi, Dzezair Murati, Ibrahim Makolli, Armend Zemaj, Kolë Berisha, Adem Hajdaraj dhe Selvije Halimi.

**Mungoi:** Branislav Grbiq.

**Të pranishëm:** Ramadan Islami – OSBE, Rrezarta Ahmeti - KDI, Reshit Gashi – NDI, Petrit Hysaj - OSBE, Driton Selmanaj – KDI, Lumnije Murati – ZPRK, Vlora Marmullakaj – EULEX dhe Gjyze Milla - Loyola Univesity Chicago.

**Nga stafi i Komisionit:** Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

**Mbledhjen e kryesoi:** Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit me këtë:

**REND DITE**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 5 qershorit 2009;
3. Shqyrtimi i propozimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës;
4. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03 - P – 117/k të datës 2 qershor 2009, për propozimin e Qeverisë për emërimin e zëvendës drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë së Pronës dhe për emërimin e dy anëtarëve të

Bordit të Agjencisë së Pronës;

5. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
6. Të ndryshme.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari – Në fillim të mbledhjes i përshëndeti të pranishmit dhe i falënderoi organizatat që e mbështesin punën e Komisionit. I njoftoi të pranishmit për rendin e ditës.

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 5 qershorit 2009**

Kryetari – I pyeti anëtarët nëse kanë vërejtje eventuale për procesverbalin.

*Procesverbali u miratua pa vërejtje.*

### **3. Shqyrtimi i propozimit të Institutit Gjyqësor të Kosovës**

Kryetari – Tha se para vetes kemi propozimet e Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe nga kjo po shihet se IGJK- ja nuk është vonuar me propozimet e veta, por mund të ketë një pengesë rreth propozimit të një minoriteti nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës. Kam biseduar edhe me kryetarin e Shoqatës së Prokurorëve, që ndoshta dikush nga Gjykata Supreme e Kosovës të propozohet, por do të bisedoj edhe me kryetarin e Gjykatës Supreme.

Mendoj se këto propozime duhet të shtyhen për mbledhjen e ardhshme, në mënyrë që Komisioni ta ftojë edhe drejtorin e IGJK- së, Lavdim Krasniqin dhe ndoshta do të ketë edhe përfaqësues nga Shoqata e Prokurorëve të Kosovës.

**Ibrahim Makolli**- Në diskutimin e tij shtroi pyetjen se çka na pengon ne nëse shkojmë me këto propozime?

**Armend Zemaj** – Duke marrë fjalën shtoi se ne paskemi kohë edhe për një javë, por nëse votojmë, unë do të jem kundër këtyre propozimeve dhe arsyeja kryesore është moshja e shtyer e këtyre kandidatëve.

**Kryetari** –Shtoi se duhet të jenë të përfaqësuar edhe minoritetet dhe propozoi që të kërkohet një shkresë ose informatë nga drejtori i IGJK-së, Lavdim Krasniqi, për propozimet e kandidatëve.

*Ky propozim i kryetarit u miratua edhe nga anëtarët e tjerë të Komisionit.*

#### **4. Shqyrtimi i përfundimit të Kryesisë së Kuvendit nr. 03 - P – 117/k të datës 2 qershor 2009, për propozimin e Qeverisë për emërimin e zëvendës drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë së Pronës dhe për emërimin e dy anëtarëve të Bordit të Agjencisë së Pronës**

**Kryetari** –Për këtë pikë të rendit të ditës shtoi se kandidatët e propozuar sipas Ligjit i plotësojnë kushtet. Përbërja është kështoj *për zëvendës drejtor* të Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës, është propozuar Albiona Dumoshi-Maloku, ndërsa për anëtarë të Bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës janë propozuar Xhevdet Maqastena dhe Aleksandar Janiqijeviq.

**Dzezair Murati** –Në diskutimin e tij shtoi se kandidati i propozuar për anëtar të Bordit, Aleksandër Janiqijeviq, i plotëson kushtet. Me sa di unë ai nuk është anëtar i asnjë partie politike.

**Bajram Kosumi** – Theksoi se kandidatët e propozuar nuk janë profesionalisht të ngritur sa duhet për Agjencinë Kosovare të Pronës.

**Adem Salihaj** –Shtoi se kandidatët e propozuar nuk i plotësojnë kriteret profesionale, por ndoshta i plotësojnë kriteret partiake dhe krahinore.

**Ibrahim Makolli** - Duke u ndërlidhur me parafolësit shtoi se nuk i përkrah këta kandidatë, sepse janë të papranueshëm dhe janë njerëz të partive politike e jo profesionistë.

**Kryetari** – Shtoi se atëherë duhet të votojmë për këta kandidatë. Komisioni votoi dhe rekomandoi kandidatët me 6 vota për, 2 vota kundër dhe 1 votë abstenim.

Albiona Dumoshi, zëvendës drejtore e Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës, Xhevdet Maqastena, anëtar i bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës, Aleksandar Janiqijeviq anëtar të bordit të Agjencisë Kosovare të Pronës.

#### **5. Shqyrtimi i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik**

**Kryetari** - Te kjo pikë e rendit të ditës propozoi që Ibrahim Makolli të jetë referues për Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, në mënyrë që për mbledhjen e ardhshme të referojë për këtë projektligj.

#### **6. Të ndryshme**

**Kryetari** – Në këtë pikë të rendit të ditës diskutoi për shqyrtimin e përfundimit të Kryesisë së Kuvendit lidhur me kërkesën e Shoqërisë Civile për ndryshimin dhe

plotësimin e Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe jemi pajtuar që të tri komisionet ta nxjerrin një përfundim të përbashkët.

Procesverbali u hartua nga stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

---

Bahri Hyseni